



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e llogarive të arkëtueshme në PFV ishte e mbivlerësuar për 1,706,601€.
- A1 Vlera e detyrimeve kontigjente në PFV ishte e mbivlerësuar për 535,966€ si rezultat i mos përditësimit me kohë të tyre me aktgjykimet e pranuar.
- B2 Ministria kishte realizuar pagesa në vlerë 120,060€, nga kategoria ekonomike jo adekuate.
- C1 Vlera e pasurive jo kapitale e prezantuar në PFV ishte e nënvlerësuar për 87,340€, si pasojë e mos regjistrimit të tyre në SIMFK dhe mos funksionimit të sistemit të e-pasurisë në AZHB.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Ministria, nuk kishte hartuar programin vjetor për grante për vitin 2025, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.
- A3 Janë evidentuar mangësi në publikimin e listave të përfituesve të pagesave direkte dhe granteve të AZHB.
- A4 Ministria nuk kishte mbajtur regjistrat e menaxhimit të kontratave përmes platformës së e-prokurimit si dhe nuk kishte publikuar njoftimet paraprake siç kërkohet me ligj.
- B3 Në gjashtë raste të pagesave për grante me vlerë të përbashkët 507,235€, kishte vonesa në pagesa prej dy deri 84 ditë, përtej afatit të lejuar me vendim.
- B4 Në dy kontrata, me vlerë të pagesave prej 116,498€, janë evidentuar mangësi në menaxhimin dhe ekzekutimin e kontratës në përputhje me kushtet e kontratës.
- A5 Ministria, përkatësisht AUV, ka kontraktuar dy projekte kapitale në mungesë të fondeve të mjaftueshme financiare, duke i tejkalluar fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit.
- A6 Ministria nuk kishte aplikuar penale për vonesat në realizimin e kontratës, ku ishin tejkalluar afatet e përcaktuara kontraktuale, për 83 ditë vonesë

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë shpalosja e vlerës së saktë të llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontigjente në PFV, klasifikimi adekuat i shpenzimeve dhe menaxhimi i pasurisë.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh duhet t'i kushtohet miratimit të programeve për zhvillim të granteve, publikimit të listave përfituese, vonesave në pagesat e granteve, menaxhimit më efikas të kontratave dhe evitimit të mangësive në fushën e prokurimit.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre nëntë janë rekomandime të reja, pesë rekomandime të përsëritura dhe një rekomandim pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare

Gjetja

Neni 16 i rregullores MF Nr 01/2017 për raportim financiar nga organizatat buxhetore përcakton "OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara".

Llogaritë e arkëtueshme duhet të njihen dhe të raportohen në pasqyrat financiare vetëm kur ekziston e drejta e vlefshme ligjore për arkëtim. Te Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) nga shtatë mostrat e testuara, në gjashtë prej tyre në vlerë totale prej 1,706,601€ është konstatuar se zërat ishin evidentuar si llogari të arkëtueshme, përderisa kishin të bënin me pasuri kontigjente (padi që APK ka bërë ndaj palëve tjera) duke mbivlerësuar regjistrat e llogarive të arkëtueshme.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos koordinimit të ZKF-ve ndërmjet APK-së dhe MPBZHR-së, ku kjo e fundit gjatë konsolidimit të PFV i ka klasifikuar jo drejtë pasuritë kontigjente në llogari të arkëtueshme.

Ndikimi

Klasifikimi jo i duhur i pasurive kontigjente si llogari të arkëtueshme ka rezultuar në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme dhe paraqitje jo të saktë të gjendjes financiare në pasqyrat financiare të MBPZHR-së. Gjithashtu, kjo rrit rrezikun e raportimit jo të besueshëm financiar dhe mund të ndikojë në vendimmarrjen e bazuar në këto pasqyra financiare.

Rekomandimi B1

Ministri, dhe Drejtori i APK-së, duhet të forcojnë sistemin e kontrolleve të

brendshme lidhur me mbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme. Ky rishikim do të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme dhe monitorim të rregullt të të dhënave financiare në mënyrë që të parandalohen gabimet dhe llogaritë e arkëtueshme të prezantohen në vlera të sakta dhe të mbështetura në dokumente burimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente në pasqyrat financiare

Gjetja

Rregullorja MF Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 18 përcakton se "Organizatrat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente". Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar për 535,966€, si rezultat i mos përditësimit me kohë të gjashtë rasteve sipas aktgjykimeve të pranuar. Rastet e mbivlerësimeve janë si më poshtë:

- Padia e shpalosur në PFV me vlerë 147,578€, edhe pse në padi nuk kishte të paracaktuar vlerë specifike, rasti kishte të bënte me mos kompensimin prej 80,015€, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimit për 67,563€.
- Padia në vlerë prej 134,300€, për të cilën me aktgjykim nga Gjykata ishte refuzuar ankesa e paditësit.
- Padia në vlerë prej 120,000€, për të cilën Gjykata Supreme me aktgjykim kishte refuzuar ankesa e paditësit.
- Padia në vlerë prej 105,550€, për të cilën Gjykata kishte refuzuar padinë, ndërsa kërkesa e vetme kishte qenë shtyrja e afatit të kontratës.
- Padia në vlerë prej 100,553€, edhe pas çështjes së rigjyimit, Gjykata kishte nxjerr aktgjykim për hedhjen poshtë të pretendimeve të paditësit.
- Padia në vlerë 8,000€, nuk kishte të bënte fare me detyrim kontingjent, pasi padia ishte bërë nga Ministria me kërkesën për kthim të mjeteve/masë sigurie lidhur me mos-përmbushjen e projektit nga përfituesi. Për rrjedhojë, rasti duhej të trajtohej si pasuri kontingjente dhe jo si detyrim kontingjent.

Mos përditësimi i listës së detyrimeve kontingjente nga zyra ligjore me të dhënat/aktvendimet e fundit nga gjykatat ishte shkaktari kryesor i mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente.

Ndikimi

Mos-përditësimi me kohë nga zyra ligjore i listës së rasteve sipas të dhënave dhe aktvendimeve të fundit të gjykatave, ka ndikuar në mbivlerësimin dhe prezantimin jo të drejtë të detyrimeve kontingjente në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të siguroj një kordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF-së në mënyrë që detyrimet kontingjente të përditësohen në fund të vitit, me qëllim që ato të prezantohen drejtë dhe në përputhje me kërkesat e rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas rregullës financiare Nr. 01/2013, neni 18.3 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me Udhëzuesin e planit kontabël, janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet ti aplikojnë.

Për tri pagesa është identifikuar klasifikim jo adekuat i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë totale prej 120,060€, si më poshtë:

- Te kontrata “Furnizim dhe montim me kablo të energjisë elektrike në zyrat regjionale në Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan” te Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) janë evidentuar dy pagesa në vlerë të përbashkët prej 94,473€ të klasifikuara gabimisht në kategorinë e mallra dhe shërbime përderisa i përkisnin kategorisë së investimeve kapitale; dhe
- Pagesa për “Shërbime kontraktuese tjera” te AZHB në vlerë prej 25,587€ e cila kishte të bënte me kthimin në punë dhe kompensim të pagave është realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime, në vend se të regjistrohej në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo të mjaftueshme me rastin e planifikimit, ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në paraqitje jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B2 Ministri në koordinim me drejtorët e agjencive duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet përkatëse ekonomike sipas planit kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive jo financiare**

Gjetja Rregullorja MF - Nr 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Si dhe neni 6.3 përcakton se, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

,Gjatë auditimit janë evidentuar mangësi në mbajtjen dhe saktësinë e

regjistrave të pasurive në SIMFK dhe E-pasuri, si dhe nënvlerësim i pasurive në pasqyrat financiare në vlerë 87,340€, si në vijim:

- Në Agjencinë Pyjore të Kosovës (APK), në regjistrin e pasurive në SIMFK nuk figuron asnjë pronë pyjore e regjistruar. Kjo është vërtetuar përmes mostrës së parcelës kadastrale me sipërfaqe 2,000 m², e cila është në pronësi të APK-së në zonën e Rahovecit, e cila i ishte dhënë në shfrytëzim Ministrisë së Ekonomisë në vitin 2023.
- Në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), sistemi i menaxhimit të E-pasurisë nuk ishte funksional. Si pasojë, pasuritë nuk janë regjistruar në sistem dhe nuk janë reflektuar në Pasqyrat Vjetore Financiare të konsoliduara të MBPZHR-së. Kjo është vërtetuar në dy raste, te blerjet e teknologjisë informative/blerjet e kompjuterëve dhe monitorëve me vlerë 38,010€ dhe blerja e mobiljeve në vlerë 14,835€; si dhe
- Në Ministri, është evidentuar se për pagesën “Rehabilitimi i Rrjetit Rrugor të Zonava Vreshtare të Republikës së Kosovës” fatura për punë të përfunduara dhe të pranuar nga komisioni i pranimit ishte në vlerë 344,956€, mirëpo në SIMFK ishte regjistruar vlera prej 310,461€ (pas ndalesës prej 10% sipas kushteve kontratuale).

Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria në AZHB ka ndodhur për shkak të mosfunksionalizimit të sistemit E-pasuria, përderisa mangësitë e tjera të identifikuara kanë ndodhur si rezultat i mungesës së një mekanizmi efektiv të kontrolleve të brendshme dhe moszbatimit të plotë të procedurave të regjistrimit të pasurive.

Ndikimi

Gabimet në regjistrim, mos regjistrimi i plotë dhe i drejtë i pasurisë sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore, kanë ndikuar në nënvlerësimin e regjistrave të pasurive si dhe në prezantimin e informatave jo të sakta të pasurive në PFV.

Rekomandimi C1

Ministri, në bashkëpunim me Drejtorët e agjencioneve, duhet të forcojnë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurisë, duke siguruar regjistrimin e plotë të pasurive jo financiare dhe sipas vlerave të sakta. Poashtu duhet siguruar, funksionalizimin e sistemit të e-pasurisë në AZHB. Kjo do të mundësojë që gjendja e pasurive e prezantuar në pasqyrat financiare të jetë e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mos hartimi i Programit Vjetor për Grante për vitin 2025

Gjetja Sipas nenit 8, pika 1 dhe 2 e Ligjit Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ministri është i obliguar të miratojë programin vjetor për bujqësi dhe zhvillim rural, i cili përmban masat për një vit kalendarik për arritjen e objektivave të politikës bujqësore, përfshirë Programin për Zhvillim Rural (PZhR).

Gjatë auditimit është konstatuar se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka hartuar dhe miratuar Programin Vjetor për Grante për vitin 2025, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Mos hartimi i programit vjetor ka ndodhur si rezultat i planifikimit të pamjaftueshëm strategjik nga strukturat përgjegjëse, dhe mungesës së mekanizmave efektiv të monitorimit për zbatimin e obligimeve ligjore.

Ndikimi Mungesa e programit vjetor për grante rrit rrezikun e shpërndarjes joefikase dhe jo transparente të fondeve publike, ndikon në përkrahjen e fermerëve dhe zhvillimin e sektorit bujqësor, krijon pasiguri për përfituesit potencialë dhe vonesa në implementimin e masave mbështetëse. Po ashtu, cenon përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe dobëson llogaridhënien institucionale.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë hartimin dhe miratimin me kohë të Programit Vjetor për Grante, në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi, duke forcuar mekanizma efektivë të planifikimit dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim të përkrahjes së qëndrueshme për fermerët dhe zhvillimin e sektorit bujqësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në publikimin e listave të përfituesve të pagesave direkte dhe granteve

Gjetja Sipas nenit 17 pika 5, të Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, "Ministria çdo vit publikon listën e përfituesve që përfshin, masën, shumën dhe informatat tjera relevante për përfituesit" me qëllim të sigurimit të transparencës dhe informimit publik.

Gjatë auditimit kemi evidentuar mangësi në publikimin e listave të përfituesve si në vijim:

- Nuk ishin publikuar listat e përfituesve juridikë për pagesat direkte për vitin 2025 si dhe lista e përfituesve të granteve të Programit për Zhvillim Rural (PZhR) 2024 për Masën 3.5 - Prodhimi i verërave.
- Listat tjera të përfituesve të granteve të PZHR-së të vitit 2024 ishin publikuar në mënyrë jo të plotë, pasi mungonin disa përfitues në listat e publikuara, evidentuar nga tetë raste ku përfituesit nuk ishin përfshirë në listat e publikuara. Po ashtu, sa i përket listave që nuk ishin publikuar fare, kjo u evidentua nga 21 raste apo pagesa të ekzekutuara.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, listat nuk publikohen derisa të përfundojë procesi i ekzekutimit të pagesave për të gjithë përfituesit, pavarësisht që me sistem njoftohen përfituesit. Ndërsa, mosazhurnimi dhe publikimi jo i plotë i disa listave ka ardhur si pasojë e problemeve teknike të ndërlidhura me mungesën e menaxherit të kontratës për mirëmbajtjen e ueb-faqes së AZHB-së.

Ndikimi	Mospublikimi dhe publikimi jo i plotë i listave të përfituesve ul nivelin e transparencës dhe besueshmërisë së publikut, kufizon qasjen e publikut në informata lidhur me shpenzimin e mjeteve buxhetore, si dhe cenon përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe parimet e llogaridhënies.
Rekomandimi A3	Ministri në kordinim me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) duhet të sigurojë publikimin me kohë, të plotë dhe të azhurnuar të listave të përfituesve, për pagesat direkte dhe grantet, duke vendosur procedura të qarta, kontrole efektive dhe mekanizma monitorues për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe publikimit në kohë reale të të dhënave në ueb-faqen zyrtare të AZHB-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik

Gjetja	Sipas Rregullores Nr. 001/2022 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), konkretisht nenit 70.1 dhe paragrafit 70.24.f, administrimi i kontratave duhet të realizohet përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi). Paragraf përcakton se Menaxheri i Kontratës është i obliguar të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mirëmbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhimin e kontratës në sistemin e prokurimit elektronik. Tutje, Neni 39 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përcakton se “Kur një autoritet kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të, një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej pesë qind mijë (500.000€), lidhur me secilën kategori të përmendur autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak”.
---------------	---

Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik në ministri dhe agjencionet e saj, si në vijim:

- Në 11 kontrata, menaxherët e kontratave nuk kishin evidentuar dhe azhurnuar në mënyrë të rregullt të gjitha pagesat e kryera në modulën e menaxhimit të kontratave në sistemin elektronik të prokurimit; dhe
- Në tri procedura të planifikuara me vlerë individuale mbi 500,000€, autoriteti kontraktues nuk kishte përgatitur dhe publikuar njoftim paraprak për dhënien e kontratave. Bazuar në informatat nga AK, praktika e njoftimit paraprak nuk ishte duke u aplikuar.

Mangësitë e evidentuara janë rezultat i mungesës së kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme në procesin e menaxhimit të kontratave dhe zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e prokurimit publik.

Ndikimi	Mos mbajtja dhe mos arkivimi i kontratave në sistemin e prokurimit publik ndikon në menaxhim joefektiv të kontratave dhe kufizon qasjen e
----------------	---

menaxhmentit në informata të sakta dhe me kohë mbi progresin dhe performancën e tyre. Ndërsa, mos aplikimi i njoftimit paraprak ul transparencën ndaj operatorëve ekonomikë, kufizon përgatitjen e tyre për prokurimet e ardhshme dhe pengon përdorimin e afateve të shkurtuara të ofertimit kur ato janë të lejueshme.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë që përmes menaxherëve të kontratave, menaxhimi i kontratave të realizohet përmes modulit të e-prokurimit, për të mundësuar mbikëqyrje më efikase nga menaxhmenti. Po ashtu, duhet të sigurohet publikimi i njoftimeve paraprake për të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të parashikuar mbi 500,000€, me qëllim rritjen e transparencës dhe garantimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në realizimin e pagesave për grante

Gjetja Sipas vendimeve të lëshuara për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural, pika 7 e secilit vendim, përcakton se shuma e përkrahjes publike për ekzekutim sipas vendimit, duhet të transferohet në llogari të përfituesit në afat prej 30 ditëve.

Në gjashtë raste të identifikuara, pagesat për përfituesit e Programit për Zhvillim Rural janë realizuar me vonesa prej 2 deri në 84 ditë pas afatit të përcaktuar me vendim. Vonesat janë paraqitur si në vijim:

- Masa 1 - Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, sektori 1.5 (Prodhimi i mishit/rritja e viçit) vendimi 06.11.2024, ndërsa pagesa me datë 28.02.2025 në vlerë prej 31,552€ - vonesë 84 ditë.
- Masa 7 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, sektori 7.5 (Aktivitetet jo-bujqësore në zonat rurale), vendimi 13.02.2025, ndërsa pagesa me datë 15.05.2025 në vlerë prej 35,000€ - vonesë 63 ditë.
- Masa 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, sektori 3.4 (Përpunimi i pemëve dhe perimeve), vendimi 27.10.2025 ndërsa pagesa me datë 12.12.2025 në vlerë prej 142,717€ - vonesë 15 ditë.
- Masa 1 - Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, sektori 3.1 (Përpunimi i qumështit), vendimi 12.11.2025 ndërsa pagesa me datë 16.12.2025 në vlerë prej 99,475€ - vonesë 4 ditë.
- Masa 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, sektori 3.6 (Pika grumbulluese/depo), vendimi 11.11.2025, ndërsa pagesa me datë 15.12.2025 në vlerë prej 98,810€ - vonesë 3 ditë.
- Masa 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, sektori 3.6 (Pika grumbulluese/depo), vendimi 10.11.2025 ndërsa pagesa me datë 12.12.2025 në vlerë prej 99,681€ - vonesë 2 ditë.

Vonesat në ekzekutimin e pagesave pas afatit të përcaktuar janë rezultat i mungesës së një sistemi efektiv të kontrollit në menaxhmin e pagesave për

grante.

- Ndikimi** Vonesat në realizimin e pagesave mund të shkaktojnë rritje të mundshme të kostove, si dhe shtyrje të afatit të planifikuar për realizim të projektit.
- Rekomandimi B3** Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv të AZhB-së, duhet të siguroj kontrolle më efektive të procedimit të pagesave në mënyrë që të gjitha vendimet e miratuara për ekzekutim të pagesave për përfituesit të realizohen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në menaxhim dhe ekzekutim të kontratës

Gjetja Rregulla financiare Nr. 01/2013 MF- shpenzimi i parave publike, Neni 24 pika 1, përcakton "Të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit".

Gjatë auditimit janë evidentuar mangësi në menaxhimin e kontratave në dy raste, si vijon, si në vijim:

1. Kontrata për "Shërbimet e repelimit të kafshëve dhe dezinfektimit të fermave për sëmundjen Ethe Hemorragjike - Krime Kongo" kishte këto mangësi:

- Në dy pagesa me vlerë të përbashkët 109,035€, të datës 10.12.2025, janë konstatuar mospërputhje ndërmjet raportit të komisionit për pranimin e shërbimeve dhe faturës së pranuar sa i përket sasisë së shërbimeve të kryera.
- Sipas komisionit, janë verifikuar 1,176 krerë të trajtuar, ndërsa në faturë janë faturuar 3,600 krerë të trajtuar, duke paraqitur dallime të theksuara ndërmjet shërbimeve të kryera dhe atyre të faturuara, kjo pasi komisioni e kryen verifikimin me mostrim, sepse sipas tyre është e pamundur të verifikohet i tërë popullacioni.
- Menaxheri i kontratës ka pranuar faturën e plotë nga OE, pavarësisht mos përputhjeve të evidentuara, bazuar në raportet e gjeneruara në excel nga OE, duke i pranuar të mirëqena, pa verifikim të pavarur. Vlen të ceket se certifikuesi nuk ka kryer certifikimin e pagesës në vlerë prej për 66,036€ për shkak të këtyre mospërputhjeve, ndërsa OE ka realizuar pagesën me procedurë përmbartimore.

2. Kontrata kornizë për "Zhvillimin e zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese" e nënshkruar 29.11.2023, në vlerë 201,500€:

- Është konstatuar mospërputhje ndërmjet raportit të menaxherit të kontratës dhe faturave të pranuar nga OE. Për faturat në vlerë prej 198,921€, menaxheri i kontratës pavarësisht që kishte pranuar ato ka konstatuar se nuk janë kryer shërbimet e faturuara. Vlera e shërbimeve që është pranuar sipas menaxherit ishte 185,475€ me një diferencë prej 13,445€, për të cilën OE kishte inicuar procedurë përmbartimore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të një monitorimi të duhur nga ana e komisionit dhe menaxherit të kontratës për të siguruar që kontrata po përmbushet.

Ndikimi Mungesa e mbikëqyrjes së duhur rrit rrezikun e pranimit të shërbimeve të pa verifikuara dhe të pagesave jo në përputhje me kontratën, duke ndikuar në uljen e transparencës dhe rritjen e kostove shtesë për shkak të procedurave përmbartimore.

Rekomandimi B4 Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e AUV-së duhet të forcojnë kontrollet dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave nga ana e menaxherëve dhe komisioneve të pranimit. Njëherit, menaxherët e kontratave nuk duhet të pranojnë fatura që tejkalojnë vlerën e shërbimeve të kryera, me qëllim të parandalimit të pagesave të parregullta dhe humbjeve financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme

Gjetja Neni 12, paragrafi 7 i Ligji nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025, limitet në zotime dhe shpenzime, parasheh që nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në raste se shpenzime e tilla për kosto totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim. Te tabela 3.2 Projektet Kapitale për Nivelin Qëndror, planifikohet financimi i projekteve dhe shuma e ndarë që duhet të realizohen brenda tri viteve.

AUV në dy raste kishte hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme financiare, në vlerë totale prej 1,246,562€, duke i tejkualuar fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit për kontratat si më poshtë:

- Kontrata për projektin “Ndërtimi i zyreve regjionale në Ferizaj” Lot 1, në vlerë prej 719,065€, e nënshkruar më 18.03.2025, me afat realizimi 350 ditë pune. Sipas Ligjit të Buxhetit 2025, për këtë projekt ishin ndarë vetëm 30,000€ për tri vite duke rezultuar me një tejkalim prej 689,065€, dhe
- Kontrata për projektin “Ndërtimi i zyreve regjionale në Gjakovë” Lot 2, në vlerë prej 587,497€, e nënshkruar më 24.03.2025, me afat realizimi 350 ditë pune. Edhe për këtë projekt, sipas Ligjit të Buxhetit 2025, ishin ndarë vetëm 30,000€ për tri vite me një tejkalim prej 557,497€.

Vlen të ceket se projekti për ndërtimin e zyreve regjionale në Gjakovë, nuk ka filluar së zbatuari, pasi në teren kanë dalë probleme teknike që e kanë pamundësuar fillimin e punëve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit, si dhe mungesës së planifikimit të mirëfilltë buxhetore për projekte të caktuara.

Ndikimi Mungesa e planifikimit të mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të ministrisë përkatësisht AUV-së ngase duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve dhe rrit rrezikun e kostove shtesë.

Rekomandimi A5 Ministri në koordinim me Drejtorin e AUV-it, duhet të sigurojnë që para fillimit të procedurave të prokurimit të bëhen të gjitha kontrollet e nevojshme, për të verifikuar se projektet kapitale kanë fonde të mjaftueshme të ndara në buxhet, dhe që kontratat të lidhen vetëm kur ekzistojnë fonde të mjaftueshme për realizimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Vonesë në përmbushjen e kontratës

Gjetja Sipas kushteve kontraktuale, afatet dhe kushtet e liferimit të produkteve/mallit janë të definuara dhe afati për dorëzim, do të llogaritet nga koha e lëshimit të urdhërbljes nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK). Në rastet kur Operatori ekonomik nuk arrin që t'i dorëzoj produktet, shërbimet ose punët sipas kushteve të kontratës AK do të ketë të drejtë që të aplikoj penalet.

Kontrata “Furnizim dhe montim me kabëll të energjisë elektrike në zyret regionale në Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan”, në vlerë prej 58,631€, e datës 24.06.2025, parashihte që shërbimet të përfundonin brenda 90 ditëve nga data e lëshimit të urdhërbljes.

Urdhërblerja është lëshuar me 03.07.2025 ndërsa shërbimi, sipas raportit të pranimit, është realizuar më 23.12.2025. Rrjedhimisht, pranimi i shërbimeve është realizuar me vonesë prej 83 ditësh pas afatit të përcaktuar në kontratë. Megjithatë, nuk është evidentuar aplikimi i penaliteteve kontraktuale për vonesën e shkaktuar.

Për më tepër raporti i menaxherit të kontratës nuk përmbante detaje të mjaftueshme lidhur me nivelin e realizimit të kontratës, duke kufizuar monitorimin e ekzekutimit të saj.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dobësive në menaxhimin e kontratës dhe në monitorimin jo të mjaftueshëm gjatë zbatimit të saj.

Ndikimi Vonesat në përmbushjen e kontratës ndikojnë negativisht në realizimin me kohë të furnizimeve dhe punëve të planifikuara. Ndërsa, mos aplikimi i penaliteteve kufizon mundësinë e ministrisë për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga mosrespektimi i kushteve kontraktuale.

Rekomandimi A6 Ministri përmes menaxherëve përkatës, duhet të sigurojë përmbushjen e kontratave sipas afateve të përcaktuara, në të kundërtën të aplikojnë penalet në rastet e mosrespektimit të kushteve kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final dhe shpenzimet për paga dhe mëditje ishte 7,191,807€ apo 100% e buxhetit.

Çështja A7 - Mos azhurnimi i akt emërimeve sipas ligjit për zyrtarët publik

Gjetja

Sipas nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm (pika 1.2) përcakton se: “Organogrami i detajuar i institucionit, duhet të përcaktojë klasën e secilës pozitë të punës dhe grupin e çdo pozite të kategorisë profesionale në pajtim me dispozitat për klasifikimin në Shërbimin Civil sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë”, dhe

Tutje, Neni 102 pika 2 i Ligjit Nr 08L-187, për zyrtarët publik, përcakton që “Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik” dhe neni 103 pika 1 “Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren në afat prej një (1) viti nga hyrja në fuqi”.

Në bazë të kërkesës së DMZP-së për ekuivalentimin e koeficienteve në vitin 2023 dhe propozimeve të AUV-së dhe AZHB-së, pozitat profesionale si Kimist, Veterinar, Biolog, Zyrtar për Analiza Laboratorike dhe Zyrtar i Lartë i Kontrollit janë klasifikuar në kategorinë “Specialist”, sipas Katalogut të Vendeve të Punës dhe sistemit SIMBNJ.

Megjithatë, pas procesit të ekuivalentimit, rregulloret e brendshme të AUV-së dhe AZHB-së nuk janë miratuar dhe si pasojë, nuk janë nxjerrë aktemërime të reja për harmonizimin e pozitave aktuale me kategorinë “Specialist”. Lidhur me këtë, aktemërimet ekzistuese nuk reflektojnë klasifikimin aktual të pozitave sipas katalogut të vendeve të punës, dhe ligjit të ri të pagave.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos miratimit të rregullores së brendshme të AUV-së dhe AZHB-së, si dhe mungesës së nxjerrjes së akt emërimeve të reja pas procesit të ekuivalentimit të koeficienteve në kuadër të Ligjit të ri të Pagave.

Ndikimi

Kjo situatë mund të ndikojë në paqartësi lidhur me statusin formal të pozitave dhe përgjegjësive të punonjësve, si dhe në mospërputhje ndërmjet aktemërimit dhe strukturës së klasifikimit të vendeve të punës. Gjithashtu, mund të kufizojë harmonizimin e plotë të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të krijojë sfida në zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave të klasifikimit.

Rekomandimi A7

Ministri, në koordinim me drejtorët e agjencioneve, duhet të ndërmarrë masa për finalizimin dhe miratimin e Rregulloreve të Brendshme të AUV-së dhe AZHB-së, si dhe të sigurojë nxjerrjen e akt emërimeve të reja, të cilat do të jenë të harmonizuara me katalogun e vendeve të punës, ligjin e pagave dhe sistemin SIMBNJ.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2025 ishte 6,094,709€, prej tyre ishin shpenzuar 5,729,442€, apo rreth 94%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizim me pajisje, furnizime me material shpenzues, furnizim me material, shërbime kontraktuese, etj.

Çështja A8 - Dhënia e kontratës në mungesë të plotësimit të kriterit të vendosur në dosjen e tenderët.

Gjetja

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Te procedura e prokurimit për projektin “Mbjellja e farave për prodhimin e fidaneve dhe mirëmbajtja e tyre” në vlerë prej 97,667€, kemi vërejtur se operatori ekonomik (OE) është shpërblyer me kontratë përkundër se nuk kishte përmbushur kërkesën III.2.4 - Kapaciteti teknik dhe profesional, të përcaktuar në dosjen e tenderit.

Në dosjen e dorëzuar nga OE mungonin referencat pozitive ose fletë-pranimet për kontratat e ngjashme apo të natyrës së njëjtë, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e kontrollit jo të mirë në vlerësimin e tenderëve nga ana e autoritetit kontraktues, konkretisht në verifikimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Ndikimi

Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara mund të rezultojë në realizim me cilësi të dobët të kontratave publike, pengon zhvillimin e një procesi të rregullt të prokurimit, cenon transparencën, barazinë dhe efektivitetin e procesit të prokurimit publik.

Rekomandimi A8

Ministri duhet të sigurojë forcimin e kontroleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 130,217,527€, pasurive jokapitale është 233,484€, si dhe e stoqeve 147,890€.

Çështja B5 - Dobësitë në formimin/raportimin e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive

Gjetja

Rregullorja Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-Financiare, neni 4.6 përcakton se Zyrtari Kryesor Administrativ themelon Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Komisionin për Inventarizimin e pasurisë jo financiare. Tutje, neni 24 Raportimi, pika 1, përcakton se pas përfundimit të procesit të inventarizimit dhe vlerësimit, si dhe pas barazimit të gjendjes faktike të pasurisë me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo-financiare, kjo gjendje duhet të përfshihet në pasqyrat vjetore financiare në përputhje me rregullën financiare për përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare.

Gjatë auditimit janë evidentuar vonesa dhe dobësi në proceset e inventarizimit dhe vlerësimit në ministri dhe agjencionet ekzekutive, si në vijim:

- AZHB, nuk ka formuar komisione për inventarizim dhe vlerësim të pasurive jo-financiare në fund të vitit, dhe rrjedhimisht nuk kishte raporte përkatëse.
- MBPZHR, AUV dhe APK kanë formuar komisione të vlerësimit të pasurive, por vetëm ministria kishte përfunduar raportin me datë 09.03.2026, pas përgatitjes së PFV-ve. Harmonizimi i gjendjes faktike me gjendjen e regjistrave të pasurive do të duhej t'i paraprijë raportimit të gjendjes së pasurive në pasqyrave vjetore financiare.

Arsyeja e mos inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive nga AZhB ishte mungesa e qartësisë në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë për të kryer një proces të pavarur. Po ashtu, sipas arsyetimeve vonesat e evidentuara në përpilimin e raporteve të vlerësimit janë ndikuar nga kompleksiteti i organizatës buxhetore, mosfunksionimi i programit e pasuria, si dhe ngarkesave në punë të zyrtarëve.

Ndikimi

Mos përfundimi me kohë i procesit të inventarizimit dhe vlerësimit rrisin rrezikun që gjendja reale e pasurisë jo-financiare të mos reflektohet me kohë dhe në mënyrë të saktë në regjistrat e pasurisë dhe në PVF, duke ndikuar në besueshmërinë e raportimit financiar.

Rekomandimi B5

Ministri dhe drejtorat e agjencioneve duhet të ndërmarrin veprime për formimin me kohë të komisioneve për inventarizim dhe vlerësim të pasurive, si dhe të sigurojnë që komisionet t'u përmbahen afateve ligjore për përgatitjen e raporteve. Kjo do të mundësojë që procesi i harmonizimit të gjendjes së pasurive jo-financiare me regjistrat përkatës të përfundojë me kohë dhe t'i paraprijë raportimit në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

MBPZHR ka të themeluara katër Njësi të Auditimit të Brendshëm (NJAB), në Ministri dhe në tre agjencione. Për vitin 2025, këto njësi kishin hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik dhe kishin realizuar auditimet e rregullta dhe ato sipas kërkesës, me përjashtim të AUV-së. Komiteti i Auditimit, kishte mbajtur katër takime, në të cilat ishin shqyrtuar aktivitetet dhe realizimi i planit vjetor të NJAB-së së ministrisë, dhe agjencioneve.

Çështja A9 - Mos realizimi i planit të auditimit nga NJAB në AUV

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 23, që përcakton përgjegjësitë e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për funksionin e auditimit të brendshëm, udhëheqësi obligohet të sigurojë funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm dhe, sipas pikës 1.4, të dorëzojë në Njësinë Qendrore Harmonizuese raportin vjetor për aktivitetet e auditimit të brendshëm, në përputhje me nenin 16 të këtij ligji.

Gjatë auditimit është konstatuar se Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në AUV për vitin 2025 kishte planifikuar katër auditime, ndërsa nuk kishte realizuar asnjë raport të auditimit për vitin 2025.

NJAB nuk ishte funksionale, si pasojë e sfidave të brendshme institucionale në sigurimin e burimeve të mjaftueshme për funksionimin e saj. Kjo ishte si rezultat i mos koordinimit të NJAB-së dhe menaxhmentit.

Ndikimi Mos funksionimi i NJAB-së, dobëson sistemin e kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes në institucion, duke rritur rrezikun që parregullsitë dhe dobësitë në menaxhimin financiar dhe operativ të mos identifikohen dhe adresohen me kohë. Si pasojë, zvogëlohet efikasiteti, llogaridhënia dhe transparencja institucionale.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të Njesisë së Auditimit të Brendshëm në AUV përmes plotësimit të kapaciteteve profesionale dhe planifikimit vjetor të auditimeve, si dhe të forcojë koordinimin ndërmjet menaxhmentit dhe NjAB-së, me qëllim realizimin e rregullt të auditimeve dhe raportimin me kohë të tyre sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë rishikimit të PFV-ve u identifikuan disa gabime që iu komunikuan menaxhmentit për korrigjime dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit. Kjo çështje nuk kërkon ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështja materiale e identifikuar dhe e përmirësuar gjatë kohës së auditimit është paraqitur si më poshtë:

Çështja 1 Gabimet e identifikuar në prezantimin e PFV-ve

Gjetja

Gjatë rishikimit të Pasqyrave Financiare Vjetore janë identifikuar disa mospërputhje dhe prezantime jo të sakta në raportim, si vijon:

Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit / Hyrja e parasë së gatshme:

- Në shënimin 9, kolona e parë (realizimi i të hyrave jo tatimore), duhet të shpalosen vetëm të hyrat jo tatimore, pasi gabimisht janë përfshirë grantet e donatorëve dhe të hyrat nga viti i kaluar.
- Në Shënimin 11, kolona e dytë (buxheti final), duhet të shpaloset vlera e granteve të përcaktuara.
- Në Shënimin 12 (tjera), duhet të shpalosen të hyrat nga viti i kaluar. Këto ndryshime duhet të reflektohen edhe në shpalosjet përkatëse, në mënyrë që të jenë në përputhje me nenin 14.

Neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit:

- Në pjesën e hyrjeve, për të hyrat jo tatimore, si në buxhetin fillestar ashtu edhe në buxhetin final, duhet të paraqiten vetëm të hyrat e projektuara.
- Grantet e përcaktuara të donatorëve duhet të shpalosen veçmas në kolonën përkatëse të granteve të përcaktuara të donatorëve dhe në buxhetin final.
- Në pjesën e daljeve, duhet të korrighohen vlerat e buxhetit fillestar dhe atij përfundimtar në SIMFK, duke përfshirë të gjitha lëvizjet buxhetore nga buxheti fillestar deri te ai përfundimtar.

Korrigjime përkatëse të buxhetit final duhet të bëhen edhe në shpalosjet e PFV-ve 2, 3, 4, 5 dhe 6, për të siguruar konsistencë të plotë të raportimit financiar.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për ti korrigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati

Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprimet korrigjuese për çështjet të cilat i kemi sugjeruar me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të saktë të shënimeve financiare në PFV.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	90,490,506	101,403,091	96,887,602	94,950,196	91,094,842
Grante Qeveritare - Buxheti	90,146,665	93,998,455	90,504,817	93,679,545	90,705,258
Të bartura nga viti i kaluar	0	241,786	241,775	142,717	183,155
Të hyrat vetanake	343,841	343,841	293,405	102,055	196,368
Donacionet e jashtme	0	6,819,009	5,847,605	1,025,879	10,061

Buxheti final i MBPZhR-së në raport me buxhetin fillestar është rritur për 10,912,585€. Ky ndryshim është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore, përfshirjes së të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe të hyrave të pranuar nga fondet e donatorëve.

Në vitin 2025, MBPZhR, ka shpenzuar 96,887,602€ apo 95% të buxhetit final.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	90,490,506	101,403,091	96,887,602	94,950,196	91,094,842
Pagat dhe mëditjet	6,767,688	7,191,807	7,191,807	6,005,013	4,966,809
Mallrat dhe shërbimet	4,887,013	5,908,587	5,572,990	6,273,567	3,401,056
Komunalitë	214,783	186,122	156,452	131,889	119,715
Subvencionet dhe transferet	74,077,022	78,444,840	77,904,008	81,221,473	81,492,355
Investimet Kapitale	4,544,000	9,671,735	6,062,347	1,318,253	1,114,906

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është rritur për 424,119€. Ky ndryshim është rezultat i rritjes së buxhetit me vendime të Qeverisë në vlerë prej 415,745€ dhe të hyrave nga fondet e donatorëve në vlerë prej 8,374€ (për AUV). Shpenzimi në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur në krahasim me buxhetin fillestar për 1,021,574€. Fillimisht ka pasur rritje nga transferi i brendshëm në vlerë 109,200€ nga kategoria e subvencioneve dhe transfer, 22,000€ nga komunalitë, 241,786€ nga të hyrat vetanake si dhe 653,057€ nga grantet. Më pas është zvogëluar buxheti me vendime të Qeverisë në vlerë prej 4,469€. Shkalla e realizimit të buxhetit final në këtë kategori ishte 94%.
- Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 28,661€. Fillimisht ishte zvogëluar për 22,000€ si rezultat i transferit të brendshëm në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe transferit prej 30,000€ në kategorinë e subvencioneve. Mandje, ishte rritur për vlerën 23,350€ nga donacionet/grantet. Shpenzimi në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte 84%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 4,367,818€. Kjo rritje është rezultat i ndarjes së mjeteve në vlerë 4,477,018€ me vendime të Qeverisë, dhe pastaj zvogëlimit të buxhetit si rezultat i transferit të brendshëm të buxhetit në vlerë 109,200€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Shkalla e realizimit të buxhetit final në këtë kategori ishte 99%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 5,127,735€. Kjo rritje është ndikuar nga rritja e buxhetit nga donacionet në vlerë prej 6,134,240€ për projektin e Bankës Botërore, si dhe zvogëlimit si rezultat i vendimeve qeveritare për kursime buxhetore në vlerë prej 1,006,505€. Shkalla e realizimit të buxhetit final në këtë kategori ishte 63%, si rezultat i vonesave në nënshkrimin e kontratave dhe realizimin e projekteve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MBPZhR në vitin 2025 ishin në vlerë 9,455,231€. Të hyrat kryesisht kanë të bëjnë me inspektime sanitare, fitosanitare dhe veterinare, shfrytëzimi i pronës publike, lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfytëzim etj. Të hyrat tjera kanë të bëjnë me kthime të mjeteve nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	9,909,137	9,909,137	9,455,231	9,230,661	9,384,032
Të hyrat jo tatimore	9,909,137	9,909,137	9,180,679	9,155,452	9,274,321
Të hyrat tjera	0	0	274,552	75,210	109,711

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka rezultuar me tetë rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, nga tetë rekomandime të dhëna, dy rekomandime ishin zbatuar, një rekomandim ishte zbatuar pjesërisht dhe pesë rekomandime nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni grafikun 2 dhe tabelën 4 të rekomandimeve.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri, dhe Drejtori i APK-së, duhet të sigurojnë se është rishikuar sistemi i kontrolleve të brendshme lidhur me mbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme. Ky rishikim do të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme dhe monitorim të rregullt të të dhënave financiare në mënyrë që të parandalohen gabimet dhe llogaritë e arkëtueshme të prezantohen në vlera të sakta dhe të mbështetura në dokumente burimore.	Edhe këtë vit, kemi evidentuar dobësi në shpalosjen/menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet përkatëse ekonomike sipas planit kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestnimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Edhe këtë vit kemi evidentuar raste të keqklasifikimit të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për opinion	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e AUV-së, duhet të përforcojnë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurisë, duke siguruar regjistrimin dhe korrigjimin e pasurive jo financiare sipas vlerave të sakta. Kjo do të mundësojë që gjendja e pasurive të prezantuar në pasqyrat financiare të jetë e plotë dhe e saktë.	Edhe pse ministria kishte arritë të bëjë përmirësime në këtë drejtim, megjithatë prapë kemi identifikuar disa mangësi në menaxhimin e pasurive jofinanciare.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri, në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AZhB-së, duhet të sigurojë kontrolle më efektive të procedimit të pagesave në mënyrë që të gjitha vendimet e miratuara për ekzekutim të pagesave për përfituesit të realizohen brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Edhe këtë vit kemi evidentuar vonesa në realizimin e pagesave për grante.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për konkluzion	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e AUV-së, duhet të forcojë kontrollet dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave duke siguruar që çdo aneks kontratë të miratohet nga autoritetet përgjegjëse me dokumentim të rregullt, penalizimet të zbatohen ndaj operatorëve që nuk përmbushin detyrimet si dhe siguria e ekzekutimit të jetë e vlefshme deri në përfundimin e plotë të kontratës për të minimizuar humbjet financiare.	Edhe këtë vit kemi evidentuar mangësi në menaxhim dhe ekzekutim të kontratave.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Baza për konkluzion	Ministri dhe Drejtori i AUV-së duhet të sigurojnë që në rastet e procedurave të tilla të aplikohen kontratat adekuate me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të fondeve dhe evitimit të mënyrave të paljuara të pagesës.	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një rivlerësim i mënyrës së menaxhimit të projektit, rezultatet e të cilit do të shërbejnë në krijimin e një strukture të qëndrueshme për analiza fillestare dhe planifikim të detajuar të mundësive dhe burimeve që do të mundësojnë realizimin e plotë të projekteve të ardhshme.	Nuk kemi evidentuar raste të ngjajshme	I zbatuar

8.	Pasuritë	Ministri, dhe Kryeshefi i AZhB-së, duhet të ndërmarrin veprime për të formuar me kohë komisionin për inventarizimin vjetor apo periodik të pasurive jo financiare, si dhe të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat rezultojnë nga ky proces duhet të pasqyrohen saktë në regjistrin e pasurive.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dobësi sa i përket procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.	Nuk ka filluar zbatimi
----	----------	--	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit




Ajtene Llapashtica, Udhëheqëse e ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Altina Selimi Palushi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Nr. i regjistruar / Reg. No.: 03-47-1116-1			
Data / Datum / Date: 23.06.2026			
Niveli / Org. Unit:	Shtet / Class:	Nr. i Prot. / Prot. No.:	Nr. i Stranica / No. Pages:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Nr. i regjistruar / Reg. No.: 1841	
Data / Datum / Date: 23.06.2026	
Prishtinë / Pristina / Pristina	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

LETËR KONFIRMIMI

Për pajtueshmërinë me gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar/a,

Përmes kësaj letre, konfirmoj se:

- kam pranuar Draft-Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm: "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në Raport dhe nuk kam komente lidhur me përmbajtjen e tij; si dhe
- brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i Raportit Final, do të dorëzoj Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

z. Armend Muja
 Ministër në detyrë i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Prishtinë, 22.06.2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Projekti me ligji të buxhetit 19002 me 30,000€ dhe projekti 19003 me 30,000€ për tre vite.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.